

... të fëmijëve në transmetime  
... esën e Autoritetit të Med  
... ive që prej muajit prill ka  
... tur më **Buletini i** shumë  
... mendime **Lëshillit të** për  
... cilave kanë **Ankesave.** N  
... të drejtë të kërkojë, të het  
... të marrë dhe të ndajë info  
... dhe ide, pa asnjë lloj censu  
... dios, tu dhe mjeteve të tjer  
... ikimit audioviziv apo ndon  
... tjetër bazuar në përzgjed  
... m nëse këtë e bën në kuad  
... timit të sundin  
... tave të njeriut.  
... me krijimin e shërbimeve



AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE

NR. 8



# *Dërbajtja*

Hyrja .....	04
Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave .....	06
<b>SEKSIONI I</b>	
Ankesa me objekt "Cënimin e rregullave të etikës dhe dinjitetit".....	09
<b>SEKSIONI II</b>	
Ankesa me objekt "Cënimin e të drejtave të fëmijëve".....	17
<b>SEKSIONI III</b>	
Ankesa të rrëzuara .....	31
<b>SEKSIONI IV</b>	
Ankesa me objekt jashtë juridiksionit të AMA-s .....	34

*Dy fjalë*

*në vend të hyrjes*

Menaxhimi i hapësirës mediatike, në të cilën operimi i ofruesve të shërbimeve mediatike si publike ashtu edhe private kryhet konform interesit publik për programe cilësore dhe respektim të normave ligjore dhe etike mbetet ende sfidë për Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve në mjedisin e sotëm të transmetimeve audiovizive përbën jo vetëm shqetësim kryesor por edhe një prej fokusin e objektivave parësore të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodi i Transmetimit, miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, sanksionon parimet themelore lidhur me respektimin e normave morale dhe etike në programet audiovizive, që u drejtohen fëmijëve. Gjashtëmujori i parë i vitit 2020, të cilit i dedikohet Buletini i 8-të i Këshillit të Ankesave përmban më së shumti shqyrtime ankesash, ku pretendohet cënim i dinjitetit të të miturve në përgjithësi dhe të të miturve, viktima të abuzimit, në veçanti.

Këshilli i Ankesave mbështet lirinë e medias dhe misionin e saj për informimin e publikut por gjithmonë duke u bazuar në parimet themelore, që mbrojnë të drejtat e njeriut e veçanërisht që i japin përparësi interesit më të lartë të fëmijës. Megjithë ekzistencën e dispozitave të posaçme ligjore, që u ndalojnë OSHMA-ve ekspozimin direkt ose indirekt të çdo fëmije, të përfshirë në një ngjarje të rëndë, shpesh gjatë raportimeve në emër të së vërtetës dhe informimit publik është vënë re, se janë cënuar disa norma ligjore dhe etike, që sjellin pasoja të parikuperueshme morale, psikologjike e sociale duke çuar në riviktimizimin e personave të prekur.

Ankesat e trajtuara në këtë buletin i janë nënshtruar procedurës së ndërveprimit mes Këshillit të Ankesave dhe ofruesit të shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA), sipas udhëzimit "Mbi procedurat e trajtimit të ankesave nga ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv (OSHMA)" miratuar në maj 2018. Ky bashkëpunim mes Këshillit të Ankesave dhe Bordeve të Shqyrtimit të Ankesave të OSHMA -ve, jo vetëm është reflektuar në

zgjidhjen e shpejtë të ankesave, duke ndihmuar gjithë procesin e shqyrtimit por përfshirja e OSHMA-së ka bërë të mundur edhe sensibilizimin e operatorëve audiovizivë lidhur me njohjen dhe zbatimin e normave dhe kërkesave ligjore të Kodit të Transmetimit dhe Ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

## Procesi i trajtimit të ankesave nga Këshilli i Ankesave

Mbështetur mbi Ligjin nr. 97/ 2013 për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit të Transmetimit, shikuesit dhe dëgjuesit e subjekteve audiovizive kanë të drejtën të ankohen rreth përmbajtjes së transmetimeve audiovizive, nëse ata besojnë dhe mendojnë që subjektet kanë cenuar apo shkelur parimet dhe rregullat etike, të hartuara në Ligjin Nr. 97/2013 dhe ato në Kodin e Transmetimit.

Por që të mund të ngrihet një ankesë duhet të identifikohet më parë programi apo emisioni, të cilit ankesa i referohet, duke përfshirë datën dhe kohën e transmetimit. Gjithashtu, ankuesi duhet të shpjegojë se çfarë cenimi/shkelje ka vërejtur në përmbajtjen e programit që e ka detyruar atë të ngrejë një ankesë.

Është shumë e rëndësishme të përcaktohen qartësisht argumentet e një ankesë dhe përse materiali programor apo përmbajtja komerciale nuk pajtohet me parimet, rregullat, kërkesat dhe praktikën e përcaktuara në Ligjin nr. 97/2013 dhe në Kodin e Transmetimit. Ligji për mediat audiovizive dhe Kodi i Transmetimit mund të gjenden në faqen zyrtare të AMA-s: [www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al).

Në një nga seksionet e kësaj faqeje, pasi të klikoni në rubrikën "**Formular ankesë për shkeljen e Kodit të Transmetimit**", plotësoni formularin me të dhënat që kërkohen ose mund të shkruani në adresën zyrtare të AMA-s: [info@ama.gov.al](mailto:info@ama.gov.al). Në përputhje me procesin e ankimit, shikuesi apo dëgjuesi duhet të dërgojë ankesën në adresën që gjendet në fund të fletës së ankesës, pasi ka lexuar me kujdes udhëzimet për hartimin e saj, por mbi të gjitha parimet dhe rregullat e Kodit të Transmetimit.

Në disa raste, publiku vetë mund t'ua drejtojë OSHMA-ve ankesat që ai harton, kur e mendon se kjo është një rrugë më e shpejtë dhe që subjekti mund të reflektojë. Kur shikuesi apo dëgjuesi nuk mbetet i kënaqur me përgjigjen nga transmetuesit ose, nëse transmetuesi nuk përgjigjet, atëherë ai mund ta referojë ankesën e tij në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, në faqen e tij zyrtare ose me postë.

Sa i përket trajtimit të ankesës, Këshilli i Ankesave në shqyrtimin e çdo ankesë që i mbërrin, bazohet mbi kodet dhe rregullat përkatëse në ligj, në materialin e shkruar të paraqitur nga palët përkatëse, si dhe materialin e transmetimit. Ankesat shqyrtohen në nivel ekzekutiv nga Këshilli i Ankesave, në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të AMA-s, si Drejtoria e Programeve, Drejtoria Juridike dhe ajo e Mbikëqyrjes.

Detajet e shqyrtimit dhe vendimet mbi ankesat për përmbajtjen e transmetimeve audiovizive të marra nga Këshilli i Ankesave janë publikuar në këtë dokument, i cili quhet **Buletini i Këshillit të Ankesave**. Vendimet merren mbi çështjen, nëse një program apo një komunikim tregtar ka apo nuk ka respektuar kërkesat përkatëse ligjore dhe rregullat e Kodit të Transmetimit. Vendimet nuk lidhen me miratimin apo përkrahjen që mund t'u bëhet palëve në ankesë dhe gjithashtu ato nuk vijnë si rezultat i trajtimit të çdo aspekti të detajuar që përmban vetë ankesa. Këshilli i Ankesave nuk kryen asnjë vlerësim të veçantë apo të pavarur jashtë çështjeve të parashtruara në ankesë.



Ankesa me  
objekt  
"Cënimin e  
rregullave  
të etikës  
dhe dinjitetit"

Ankesa e paraqitur nga:

**Familjarë të të ndierit (K.R)**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Klan Top Channel Vizion Plus Ora News News 24 Report TV TV Rozafa Motiv Fax TV A2 TV Star Plus TV	Edicionet Informative	07.08.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020 07.01.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s mori një ankesë nga familjarët e të ndierit K.R, i vrarë me armë zjarri më datë 07.01.2020, në qytetin e Rrëshenit. Familjarët pretendonin se 11 media audiovizive transmetuan dhe ritransmetuan pamje të vrasjes së familjarit të tyre. Sipas ankuesve pamjet e ekzekutimit të shtetasit K.R ishin transmetuar dhe ritransmetuar në mediata audiovizive "duke shkaktuar stres tek bashkëshortja shtatzënë, familjarët e të ndierit, por në veçanti, tek djali i mitur i çiftit Reçi". Familjarët ankoheshin se pamje të tilla ishin të rënda, sensitive dhe private.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi pamjet filmike përkatëse dhe transmetimet e deriatëhershme nga operatorët audiovizive gjatë edicioneve informative, por jo vetëm, Këshilli i Ankesave konstatoi se përmbajtja e tyre është e rëndë, sensitive dhe private dhe se transmetimi i tyre ka qenë në shkelje të normave ligjore dhe etike. Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, përmes shkresave të dërguara OSHMA-ve, u kujtoi atyre parimet themelore të veprimtarisë së tyre "...veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike

e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesa dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve" (neni 4, pika 1/b, ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar).

Gjithashtu Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, detyron OSHMA-të të respektojnë të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale : "Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi ose kur materiali në fjalë duhet të publikohet në interes të publikut, duke e tejkaluar të drejtën e privatësisë. Gazetari duhet të sigurohet, për të zbatuar standardet më të larta profesionale që informacioni i dhënë të jetë i saktë, i paraqitur në mënyrë të drejtë dhe objektive, veçanërisht kur përfshin zbulimin e aspekteve të jetës private ose të të dhënave personale..." (Seksioni 3, "E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale", pika 3.1).

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive u kërkoi mediave audiovizive ndërprerjen e transmetimit të mëtejshëm të pamjeve filmike të ekzekutimit të shtetasit K.R.

Ankesa e paraqitur nga:

**Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
TV Klan	Serial filmik "Narcos"	13,14,15.01.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori disa ankesa në adresë të serialit filmik "Narcos", të transmetuar në televizionin "Klan", në datat 13,14,15.01.2020, në orën 21.00. Sipas ankuesve seriali përmbante skena të rënda dhune dhe seksi, megjithëse transmetohej në një orar, që mund të ndiqet lehtësisht edhe nga fëmijët.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes pamjet filmike të serialit në fjalë dhe konstatoi pamje të rënda dhune dhe seksi. Pavarësisht se televizioni kishte vendosur paralajmërimin viziv, Këshilli i Ankesave vlerësoi se transmetimi i këtij seriali në orën 21:00 është në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar në nenin 33 të tij, sanksionon të gjitha detyrimet e OSHMA-ve, ku bën pjesë edhe detyrimi, që "të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror" (pika 1, germa e).

Edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar me vendimin e AMA-s nr.228 datë 11.12.2017, siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive.

Në seksionin 5 të Kodit të Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", përcaktohen qartë rregullat, që duhet të kenë parasysh OSHMA-të gjatë transmetimit të programeve të tyre.

Pika 5.30 e Kodit u ndalon OSHMA-ve të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe, që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale. Gjithashtu, "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (Ora kufi 22:00-06:00)", (pika 5.34).

Bazuar sa më sipër, duke vlerësuar se, seriali "Narcos", i cili ndonëse përmban skena dhune dhe seksi, transmetohet në një orar të papërshtatshëm dhe mund të dëmtojë zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit. Gjithashtu Këshilli i Ankesave kërkoi ndërprerjen e transmetimit të serialit "Narcos" në orarin aktual dhe zhvendosjen e transmetimit të tij në orarin kufi që përcakton Kodi i Transmetimit, duke shoqëruar, vazhdimisht me shenjën paralajmëruese, sipas pikës 5.48 të Kodit.

Ankesa e paraqitur nga: **E.A**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

**Top Channel****Edicion informativ****20.01.2020****1. Përmbledhje e Ankesës**

Shtetasi E.N pretendonte se ishte filmuar, pa dijeninë e tij, në hyrje të pallatit ku banon duke cënuar kështu jetën private dhe profesionale. Ankuesi i referohej një kronike informative të "Top Channel", transmetuar më datë 20.01.2020, në çdo edicion informativ. Pretendohej se prania e tij në këto pamje asociohej me problematikën e trajtuar në kronikë duke cënuar rëndë imazhin e tij.

**2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave**

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi pamjet filmike, bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit "OSHMA-ja është e detyruar të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 të këtij ligji, mbi cilësinë e shërbimit të ofruar ose përmbyshjen e detyrimeve kontraktore për shërbimet me abonim", i kërkoi OSHMA-së paraqitjen e pretendimeve lidhur me ankesën e shtetasit E.N. Në përgjigje të ankesës, OSHMA-ja sqaroi se "edhe pse në asnjë rast nuk është drejt-përsëdrejti inintervistuar apo inkuadruar Ankuesi por është kapur nga kamerat rastësisht, televizioni "Top Channel" ka hequr videon dhe linkun e artikullit nga kanali zyrtar në "Youtube", me qëllim garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve".

Ankesa e paraqitur nga: **E.N**

Subjekti audioviziv

Programi

Data

**Top Channel****Open****10.02.2020****1. Përmbledhje e Ankesës**

Ankuesi E.N pretendonte se gjatë emisionit "Open", të transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 10.02.2020 në orën 22:00, gjatë një aksioni të forcave policore, janë publikuar targat e automjetit që po kontrollohej dhe fytyra e drejtuesit të tij, duke shkelur të drejtën e privatësisë.

**2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave**

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s pasi shqyrtoi pamjet filmike, kërkoi paraqitjen e pretendimeve të televizionit lidhur me këtë ankesë. Media sqaroi se "për arsye se programi ishte në transmetim Live, ishte e pamundur mbulimi i fytyrës së drejtuesit të mjetit dhe targës së mjetit". Media sqaroi më tej, se materialet filmike në fjalë ishin fshirë nga Youtube. Bazuar në nenin 51, pika 1 e ligjit 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas ligjit "OSHMA-ja është e detyruar të shqyrtojë çdo ankesë të arsyetuar të paraqitur me shkrim nga çdo person për programet e transmetuara prej tij, lidhur me zbatimin e kërkesave të nenit 33 të këtij ligji, mbi cilësinë e shërbimit të ofruar ose përmbyshjen e detyrimeve kontraktore për shërbimet me abonim".



Ankesa e paraqitur nga: **Ambasada e Greqisë në Republikën e Shqipërisë**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
<b>Top Channel</b>	<b>Gjurmë Shqiptare</b>	<b>09.05.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori një ankesë nga zj.S.P, ambasadore e Republikës së Greqisë në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përmbajtjen e emisionit "Gjurmë Shqiptare", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datë 09.05.2020. Përfaqësia e selisë diplomatike ankohej se publikimi i pamjeve të regjistruara me kamera të fshehtë cënonte privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave vlerësoi se publikimi i pamjeve të regjistruara me kamerë të fshehtë, në këtë rast, kishte ndodhur në përmbushje të interesit publik, në mungesë të alternativave të tjera për të marrë informacion. Në vlerësimin e Këshillit të Ankesave, çështja e trajtuar në emision përbën interes publik. Si e tillë, sipas Kodit të Transmetimit, *"Shpërndarja e informacionit tek publiku, duke përfshirë këtu edhe fotografitë për jetën private të individëve pa pëlqimin e tyre, është e pranueshme vetëm nëse një interes i ligjshëm publik tejkalon të drejtën e tyre për privatësi..."*

**(Seksioni 3, E drejta për privatësi dhe mbrojtjen e të drejtave personale, pika 3.1).**

Ankesa e paraqitur nga: **E.M**

<u>Subjekti audioviziv</u>	<u>Programi</u>	<u>Data</u>
<b>Top Channel</b>	<b>Fiks Fare</b>	<b>09.05.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Ankuesja E.M pretendonte se gjatë emisionit "Fiks Fare", transmetuar në televizionin "Top Channel", më datë 01.10.2020 ishte cënuar rëndë dinjiteti, privatësia, reputacioni si dhe të drejtat themelore. Sipas ankueses, gazetaria gjatë emisionit kishte mbajtur qëndrim të njëanshëm dhe nuk kishte pasqyruar të plota informacionet në dispozicion, duke shkelur Kodin e Transmetimit.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave referuar ligjit nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, i kërkoi televizionit "Top Channel" paraqitjen e pretendimeve. Në përgjigjen drejtuar Autoritetit, "Top Channel" pretendonte se i kishte dhënë ankueses mundësinë të shprehte pretendimet e veta, por ankuesja kishte refuzuar.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi se rasti në fjalë ishte trajtuar në përputhje me interesin publik, pasi bëhej fjalë për falsifikim dokumentacioni dhe shkelje të procedurave të rekrutimit në administratën publike. Televizioni "Top Channel" vendosi në dispozicion një akt të Prokurorisë së Përgjithshme, e cila ishte vënë në lëvizje pas transmetimit të emisionit, duke kërkuar anulimin e kontratës së emërimit në administratë.

Këshilli i Ankesave këqyri materialin filmik të emisionit Fiks Fare, të transmetuar më datë 01.10.2020 dhe nuk konstatoi shkelje të ligjit Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar apo të Kodit të Transmetimit.

2

Ankesa me  
objekt  
"Cënimin e  
të drejtave  
të femijëve"

Ankesa e paraqitur nga: **Ankuesi**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>Top Channel</b>	<b>Seriali "PeakyBlinders"</b>	<b>05&amp;12.01.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Këshillit të Ankesave mbërriti një ankesë në adresë të serialit "Peaky Blinders", transmetuar në televizionin "Top Channel" në datat 5 dhe 12 janar 2020, në orën 21:00. Ankuesi pretendonte se seriali kishte skena të papërshtatshme për orarin e transmetimit.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave këqyri materialin filmik dhe konstatoi shkelje të ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit. Pavarësisht shenjës paralajmëruese, të vendosur te logoja e televizionit (konkretisht: shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe në transmetimin e datës 5 Janar 2020 dhe me ngjyrë të verdhë në transmetimin e datës 12 Janar 2020), Këshilli i Ankesave konstatoi se transmetimi i këtij seriali në orën 21:00 është në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 33 të tij, sanksionon të gjitha detyrimet e OSHMA, ndër të cilët ... "të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror" (pika 1, germa e).

Edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive i miratuar me Vendimin e AMA-s nr.228, datë 11.12.2017, siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive.

Në seksionin 5 të Kodit të Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", përcaktohen qartë rregullat që duhet të kenë parasysh

OSHMA-të për transmetimin e programeve të tyre.

Pika 5.30 e Kodit u ndalon OSHMA-ve të transmetojnë programe që dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale. Gjithashtu, "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (ora kufi 22:00-06.00)", (pika 5.34).

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave kërkoi ndërprerjen e transmetimit të serialit "Peaky Blinders" në orën 21:00 dhe zhvendosjen e transmetimit të tij në orarin kufi që përcakton Kodi i Transmetimit, duke e shoqëruar vazhdimisht me shenjën paralajmëruese, sipas pikës 5.48 të Kodit.

Ankesa e paraqitur nga: **E.B**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>TV Lezha</b>	<b>Filmi "Snakes on a Plane"</b>	<b>11.01.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Këshillit të Ankesave mbërriti një ankesë nga shtetasi E.B lidhur me filmin "Snakes on a Plane", transmetuar në televizionin "Lezha", më datë 11.01.2020, në orën 09:30. Ankuesi pretendonte se filmi kishte "vrasje, përdhunime, njerëz që digjen", dhe transmetohej për rrjedhojë në një orar të papërshtatshëm.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave këqyri materialin filmik dhe konstatoi shkelje të ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit. Sipas Këshillit të Ankesave, transmetimi i këtij programi në orën 09:30 ishte në shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 33 të tij, i cili sanksionon të gjitha detyrimet e OSHMA-së, ndër të cilët ... "të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror" (pika 1, germa e).

Edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive i miratuar me Vendimin e AMA-s nr.228, datë 11.12.2017, siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive.

Në seksionin 5 të Kodit të Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", përcaktohen qartë rregullat që duhet të kenë parasysh OSHMA-të për transmetimin e programeve të tyre.

Pika 5.30 e Kodit u ndalon OSHMA-ve të transmetojnë programe që dëmtojnë seriozisht zh-

villimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe që përmbajnë pornografi ose paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale. Gjithashtu, "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime. (ora kufi 22:00-06.00)", (pika 5.34).

Teksa vlerësoi se transmetimi përmban skena të rënda dhune, kryhet në një orar të papërshtatshëm dhe mund të dëmtojë zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve, Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **E.N dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>Top Channel</b>	<b>Dua të të bëj të lumtur</b>	<b>21.01.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Në ankesën drejtuar Këshillit të Ankesave, ankuesja E.N pretendonte se gjatë transmetimit të programit "Dua të të bëj të lumtur", datë 21.01.2020, ku ishte trajtuar rasti i një nëne, e cila rriste fëmijët e saj me vështirësi ekonomike, intervista e fëmijës dhe mënyra e trajtimit nga moderatorja binte ndesh me Kodin e Transmetimit. B.K, zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale gjithashtu kishte nisur një shkresë-ankesë, ku ngrinte shqetësimin e vet lidhur me përmbajtjen e këtij programi, ku sipas saj, gjatë trajtimit të një çështjeje sociale, ishin vënë re elementë të ndërgjegjësimit për pajtim midis dhunës dhe viktimës të dhunës në familje, megjithëse sipas Konventës së Këshillit të Evropës për "Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje", ratifikuar prej shtetit shqiptar në vitin 2012, për këto raste nuk mund të ketë ndërmjetësim.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave, pasi shqyrtoi të gjithë materialin filmik të emisionit, konstatoi se në rastin në fjalë nuk ka shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit. Kodi i Transmetimit përmban 10 pika, që rregullojnë intervistimin e fëmijëve në mediat audiovizive. Në rastin konkret, vajza 11-vjeçare u intervistua në prani të nënës së saj, duke respektuar parimet e Kodit të Transmetimit. Në vlerësimin e Këshillit të Ankesave, intervista e vajzës përcollti mesazhe me interes publik si edhe në interesin më të lartë të fëmijës. Intervista dhe mesazhet e saj evidentonte një dukuri dhe një plagë sociale të shoqërisë shqiptare: famil-

jet që rrisin fëmijët në mungesë të një ose dy prindërve, në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me ankesën e zv.ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ankesave, konstatoi se nuk ka shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, apo të Kodit të Transmetimit dhe as të 10 pikave të Kodit të Transmetimit, që rregullojnë intervistimin e fëmijëve në mediat audiovizive. Përkitazi dhunës në familje, gjatë emisionit nuk u konstatua, se kishte pasur tentativa ndërmjetësimi për pajtim. Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Ankesave vlerësoi, se trajtimi i këtij fenomeni përbënte interes publik dhe se përmbajtja audiovizive synonte sensibilizim për të ndihmuar familjen. Sakaq, AMA gjeti mundësinë të ritheksonte, se mbrojtja e të miturve nga transmetimet e dëmshme audiovizive mbetet prioriteti kryesor i këtij institucioni.

Ankesa e paraqitur nga: **Disa ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>TV Klan</b>	<b>Zonë e Lirë</b>	<b>21.02.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave mori disa ankesa për emisionin "Zonë e Lirë", të transmetuar në "TV Klan", në datën 21.02.2020, në orën 21.02. Sipas ankuesve moderatori i emisionit ftonte shikuesit të ndiqnin një shfaqje erotike të dy balerinave/stripte me bikini, të cilat përformonin disa minuta në një kërcim erotik në tub. Gjatë transmetimit të këtyre skenave në ekran nuk ishte përdorur asnjë paralajmërim zanor apo pamor për pamjet e papërshtatshme.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të materialit filmik, Këshilli i Ankesave vlerësoi se pamje të tilla erotike, të transmetuara në orën 21:02 dhe pa asnjë paralajmërim audioviziv, janë në shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit.

Më konkretisht, ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në nenin 33 të tij, sanksionon të gjitha detyrimet e Operatorëve të Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA), ku bën pjesë pika d) "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik..." Edhe Kodi i Transmetimit sanksionon se, pamje të tilla erotike mund të transmetohen vetëm pas orës 22.00, të shoqëruara me shenjë paralajmëruese, me ngjyrë të kuqe.

Pika 5.48 e Kodit të Transmetimit përcakton shenjën paralajmëruese me ngjyrë të kuqe "për përmbajtje që transmetohen vetëm pas orës 22.00, me skenë të rëndësishme, psikologjike e fizike, seksuale, me keqpërdorim të fjalorit në komunikim".

Duke patur parasysh interesin e lartë të fëmi-

jës, gjithashtu, Kodi i Transmetimit, në seksionin 5 të tij, "Fëmijët në Transmetimet Audiovizive" përcakton në pikën 5.34 se : "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike, që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime (ora kufi 22.00-06.00)".

Për rrjedhojë u arrit të evidentohet se asnjë nga detyrimet ligjore dhe kërkesat e Kodit të Transmetimit nuk ishin respektuar gjatë transmetimit të skenave erotike, në emisionin "Zonë e Lirë", në orën 21:02 deri në orën 21:04.

Bazuar sa më sipër, AMA tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit si dhe kërkoi fshirjen e materialit përkatës nga kanali zyrtar i televizionit në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga:

Disa ankues

Subjekti audioviziv

Programi

Data

TV Klan

Promo e serialit "Osmani"

20.04.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli të Ankesave i mbërriti disa ankesa lidhur me shfaqjen e promos së serialit "Osmani", transmetuar në televizionin "Klan" më datë 20.04.2020 në orën 19:22. Ankuesit pretendonin se promoja kishte skena të rënda dhune si "prerja me shpatë e kokës së dy personave"

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi me kujdes promon përkatëse dhe konstatoi se, në fund të saj ka një skenë të rëndë dhune. Transmetimi i kësaj promoje të shkurtër në orën 19:22 ishte në shkelje të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Ashtu si ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 46 të tij, pika dh) edhe Kodi i Transmetimiti në pikën 5.30 të tij, sanksionojnë detyrimet e OSHMA, ndër të cilët, "...nuk lejohet të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale...".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave kërkoi ndërprerjen e transmetimit të promos në fjalë ose korrektimin e saj sipas kërkesave ligjore. AMA kërkoi gjithashtu që, në çdo transmetim audioviziv të mbahet parasysh interesi më i lartë të fëmijëve. Në përgjigje të shkresës së Këshillit të Ankesave, televizioni "Klan" njoftoi se do të reflektonte ndryshime e kërkuara.

Ankesa e paraqitur nga:

Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Subjekti audioviziv

Programi

Data

Top Channel

Fiks Fare  
dhe Edicione Informative

27,28.04.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave ka marrë dy ankesa nga Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për emisionin "Fiks Fare", të transmetuar në "Top Channel", në datat 27 dhe 28.04.2020 si dhe një kronikë lajmi. Sipas ankuesit gjatë emisionit ishte trajtuar rasti i abuzimit të dyshuar të një vajze të mitur, ndërsa në një kronikë të edicioneve informative ishte transmetuar rrëfimi i nënës së fëmijë, së ngacmuar seksualisht.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pasi shqyrtoi të gjitha materialet filmike të emisionit dhe edicioneve informative, Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit.

Sa u përket transmetimeve të emisionit "Fiks Fare", Këshilli i Ankesave vlerësoi temën e trajtuar, por çmoi se interesi publik në këtë rast do të konsiderohej i përmbushur edhe nëse e mitura, e dyshuar si viktimë e abuzimit seksual, nuk do të ishte identifikuar në mënyrë të tërthortë.

Ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar sanksionon parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, ndër të cilët edhe mbrojtjen e të miturve: "Veprimtarinë e transmetimeve audiovizive...respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve" (Parimet themelore, neni 4, pika b).

Gjithashtu edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228 datë 11.12.2017, kërkon që OSHMA-të, t'u sigurojnë të miturve mbrojtje të veçantë në transmetimet audiovizive.

Publikimi i identitetit të prindërve të vajzës, që dyshohej të ishte abuzuar seksualisht dhe i detajeve të tjera që e identifikojnë të miturën në mënyrë të tërthortë, shkelte parimin e ruajtjes së privatësisë dhe cënonte dinjitetin e të miturës, viktimë e abuzimit seksual. Transmetime të tilla mund të dëmtojnë zhvillimin moral dhe fizik të fëmijëve, ndaj kuadri legjislativ dhe rregullator kërkon që, parimi i interesit më të lartë për mbrojtjen e fëmijëve të jetë parësor në çdo vendimmarrje për transmetim, programim, pjesëmarrje apo informacion për ta, në mediat audio dhe/ose audiovizive.

Edhe në rastin e kronikës së lajmit, Këshilli i Ankesave konstatoi shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit. Intervista me nënën e vajzës së mitur, në oborrin e shtëpisë së saj, duke bërë të mundur identifikimin e tërthortë të së miturës, shkelte ligjin e sipërcituar, i cili, ndër parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive, sanksionon mbrojtjen e të miturve.

Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive, tërhoqi vëmendjen televizionit dhe kërkoi që transmetimet e ardhshme të respektonin normat ligjore dhe etike, duke patur parasysh parimin e interesit më të lartë të fëmijës. AMA kërkoi gjithashtu heqjen e videove përkatëse nga kanali zyrtar në "Youtube".

Ankesa e paraqitur nga: **Dhjetëra ankes**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>Top Channel</b>	<b>Aventurierët</b>	<b>26.05.2020</b> <b>(çdo të premte)</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Dhjetëra ankesa mbërritën në Këshillin e Ankesave lidhur me serialin "Aventurierët", të transmetuar çdo të premte në televizionin "Top Channel". Sipas ankuesve seriali përmbante skena erotike, fjalor të papërshtatshëm, konsiderohej jo edukues për fëmijët dhe të rinjtë dhe ishte në shkelje të Kodit të Transmetimit.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave shqyrtoi materialet filmike të serialit "Aventurierët", i cili transmetohej ditën e premte, pas orës 22.40, duke konstatuar skena, fjalor të papërshtatshëm dhe keqpërdorim të gjuhës. Gjatë gjithë transmetimit mungonin gjithashtu shenjat paralajmëruese për përmbajtjen e këtij seriali.

Kodi i Transmetimit detyron OSHMA-të, që krahas respektimit të orarit të lejuar të transmetimit për përmbajtje të ngjashme (vetëm pas orës 22.00), të përdorin edhe shenjat paralajmëruese.

Konkretisht, Kodi i Transmetimit përcakton në pikën 5.47, që "Shfaqja e shenjës paralajmëruese në ekran bëhet menjëherë me fillimin e programit apo filmit dhe e shoqëron atë gjatë gjithë kohës së transmetimit. Shenja paralajmëruese rishfaqet para dhe pas të gjitha ndërprerjeve të programit në vijim, deri në përfundim të tij".

Pika 5.48 përcakton llojin e shenjave të detyruara paralajmëruese: "Llojet e shenjave paralajmëruese, që do të përdoren nga OSHMA-të do të jenë tre:

- Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe, për përmbajtje që transmetohen vetëm pas orës 22.00, me skena të rënda dhune, psikologjike e fizike, seksuale, me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.*
- Shenjë paralajmëruese me ngjyrë portokalli për përmbajtje, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.*
- Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të gjelbër, për përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshirë edhe fëmijët".*

Gjithashtu, pika 5.49 përcakton se: "OSHMA-të mund të përdorin forma të ndryshme të zgjidhjes grafike për shenjat paralajmëruese, për shembull kategorizim grup moshe, por ngjyra dhe qartësia e shenjës janë elementë të pandryshueshëm dhe të detyrueshëm për të gjithë".

Për sa më sipër, Këshilli i Ankesave tërhoqi vëmendjen për shkeljen e kërkesave të Kodit të Transmetimit dhe kërkon vendosjen e shenjave paralajmëruese gjatë transmetimit të serialit "Aventurierët".

Ankesa e paraqitur nga: **Ankuese**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
<b>News 24</b>	<b>Me zemër të hapur</b>	<b>01.06.2020</b>

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshillit të Ankesave i mbërriti ankesa një teleshikueseje, e cila i referohej emisionit "Me zemër të hapur", të transmetuar në televizionin "News 24", më datë 01.06.2020, ku ishte trajtuar "Historia e 15 vjeçares së abuzuar". Ankuesja pretendonte se intervistimi në studjo i vëllait të së dyshuarës si e abuzuar seksualisht, cënonte privatësinë e së miturës, duke dëmtuar zhvillimin fizik dhe mendor të saj.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pasi shqyrtoi materialin përkatës filmik, konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive. U evidentuan masat teknike të marra nga drejtuesit e emisionit për të mos identifikuar as 15-vjeçaren, e cila dyshohej të ishte dhunuar dhe abuzuar seksualisht dhe as vëllain e saj 23 vjeçar të ftuar në studio përmes intervistës. Megjithatë, Këshilli i Ankesave vlerësoi se publikimi i detajeve të ndjeshme për çështje të tilla dëmtonte zhvillimin fizik, mendor dhe moral të saj dhe se interesi publik mund të ishte përmbushur edhe pa publikimin e detajeve sensitive për rastin në fjalë.

Kodi i Transmetimit, në pikën 5.1 ndalon çdo transmetim që mund të çojë në identifikimin e fëmijëve : "OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik".

Bazuar në sa më sipër, Këshilli i Ankesave i rikujtoi OSHMA-së që në çdo transmetim në të ardhmen, të mbahej parasysh interesi më i lartë i fëmijëve, si dhe kërkoi heqjen e materialit filmik nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Abc News	Kronikë informative	02.06.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Këshilli i Ankesave ka marrë një ankesë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë referuar transmetimit të një kronike televizive në edicionin e lajmeve të televizionit "Abc News", transmetuar në datë 02.06.2020. Ministria vlerësoi se televizioni kishte "shkelur legjislativonin në fuqi, duke publikuar të plotë dëshminë e një të mituri, pjesë e dosjes hetimore". Në zbatim të Kodit të Transmetimit, ministria kërkonte marrjen e masave ndaj subjektit televiziv për moszbatimin e detyrimeve ligjore mbi mbrojtjen e të miturve, gjatë publikimit të kronikave.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri materialin filmik dhe konstatoi shkelje të ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit, pasi publikimi i dëshmisë së vajzës së mitur, të dyshuar se është dhunuar, shoqërohej me nxjerrje të dhënash që ekspozonin identitetin e saj.

Konkretisht, gjatë transmetimit të lajmit, nga nxjerrja e dokumentit të dëshmisë së viktimës në organet përkatëse ligjzbatuese, ishin lehtësisht të lexueshme të dhënat personale të vajzës, shoqëruar me publikim më të zgjeruar në adresën zyrtare të televizionit në internet, ku mund të identifikohesh edhe numri i saj personal i telefonit, çka dëmtonte rëndë viktimën.

Referuar nenit 33 të ligjit Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, pika d) OSHMA duhet "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale".

Kodi i Transmetimit, në pikën 5.1 ndalon çdo transmetim që mund të çojë në identifikimin e një fëmije, viktimë të çdo dhune, që mund të ndikojë në rehabilitim e tij. Pika 5.1 sanksionon se "OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale, përveç rasteve me interes publik".

Për rrjedhojë, Autoriteti i Mediave Audiovizive kërkoi ndalimin e ritransmetimit të kronikës informative pa pastruar çdo të dhënë që nuk përbënte interes publik dhe mund të identifikonte viktimën si edhe heqjen e materialit filmik nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
RTV Ora	Serial televiziv	03.06.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Në Këshillin e Ankesave ka mbërritur një ankesë mbi transmetimin e një seriali televiziv, transmetuar nga "RTV Ora", më datë 03.06.2020, në orën 11:00-12:00. Ankuesi pretendonte se seriali kishte përmbajtje pornografike dhe transmetimi i tij kryhej në një orar jo të përshtatshëm.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së materialit filmik, serial prodhim i huaj, Këshilli i Ankesave konstatoi pamje të forta erotike dhe seksi, transmetuar nga televizioni duke filluar nga ora 11:00. Konkretisht, në orën 11:35, seriali i transmetuar përmbante një skenë të gjatë me përmbajtje erotike, të papranueshme për orarin e transmetimit.

Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 33 të tij, sanksionon të gjitha detyrimet e OSHMA-ve, ndër të cilët "të mos transmetojë programe pornografike pa siguruar mbrojtjen e të miturve nëpërmjet pajisjeve të aksesit të kushtëzuar dhe kontrollit prindëror" (pika 1, germa e).

Edhe Kodi i Transmetimit për mediat audiovizive, i miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017, siguron mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga transmetimet e papërshtatshme audiovizive.

Në seksionin 5 të Kodit të Transmetimit, "Fëmijët në transmetimet audiovizive", përcaktohen qartë rregullat, që duhet të ndjekin OSHMA-të për transmetimet e programeve të tyre.

Pika 5.30 e Kodit u ndalon OSHMA-ve të transmetojnë programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të fëmijëve, në veçanti filma apo programe që

përmbajnë pornografi ose që paraqesin skena dhune të skajshme dhe artificiale, gjithashtu "OSHMA-të duhet të zgjedhin orarin e transmetimit të programeve që mund të dëmtojnë zhvillimin mendor, fizik apo moral të fëmijëve, ose të marrin ndonjë masë tjetër teknike që fëmijët të mos i shikojnë ose dëgjojnë të tilla transmetime." (Ora kufi 22:00-06:00), (pika 5.34).

Njëkohësisht, Kodi i Transmetimit përcakton në pikën 5.47: "Shfaqjet e shenjës paralajmëruese, që do të përdoren nga OSHMA-të do të jenë tre: A. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të kuqe, për përmbajtje që transmetohen vetëm pas orës 22:00, me skena të rënda dhune, psikologjike, fizike, seksuale e me keqpërdorim të gjuhës, fjalorit dhe etikës së komunikimit.

B. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë portokalli për përmbajtje, të cilat fëmijët duhet t'i ndjekin të shoqëruar nga të rriturit.

C. Shenjë paralajmëruese me ngjyrë të gjelbër, për përmbajtje që mund të ndiqen nga të gjithë, përfshirë edhe fëmijët".

Sa më sipër, duke vlerësuar se, seriali përmbante skena seksi, transmetohej në një orar të papërshtatshëm dhe mund të dëmtonte zhvillimin mendor, fizik ose moral të fëmijëve, AMA tërhoqi vëmendjen për shkelje të ligjit nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të Kodit të Transmetimit si dhe kërkoi ndërprerjen e transmetimit të tij në orarin kufi, të përcaktuar nga Kodi i Transmetimit, duke e shoqëruar vazhdimisht me shenjën paralajmëruese, sikurse e përcakton pika 5.48 e Kodit të Transmetimit.

Ankesa e paraqitur nga: **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Klan +	Edicion informativ	01.06.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Këllit të Ankesave të Autoritetit të Mediave Audiovizive ka mbërritur një ankesë mbi transmetimin e një kronike televizive në edicionin e lajmeve në televizionin "Klan Plus", sipas të cilës identifikohet babai i një vajze 15-vjeçare të dhunuar rëndë. Sipas ankesës së Agjencisë Shtetërore të Mbrojtjes të të Drejtave të Fëmijëve, kronika e televizionit Klan Plus "ka publikuar intervistën e babait të vajzës së abuzuar" dhe përmes publikimit të këtyre detajeve, mund të identifikohet vajza në fjalë.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas marrjes së ankesës, Këshilli i Ankesave këqyri materialin filmik dhe konstatoi shkelje të ligjit për mediat audiovizive dhe të Kodit të Transmetimit. Babai i së miturës, e dyshuar se është dhunuar, intervistohet i pambuluar duke ekspozuar identitetin e tij dhe njëkohësisht atë të viktimës.

Referuar nenit 33 të ligjit Nr.97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Detyrimet e OSHMA-ve, pika d) OSHMA duhet "të respektojë rregullat e etikës dhe moralit publik dhe të mos transmetojë programe që mund të nxisin vepra penale".

Kodi i Transmetimit, në pikën 5.1 ndalon çdo transmetim që mund të çojë në identifikimin e një fëmije, që është viktimë e çdo dhune që mund të ndikojë në rehabilitim. Pika 5.1 sanksionon se "OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një

*vepre penale, përveç rasteve me interes publik".* Për sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive kërkoi ndalimin e ritransmetimit të kronikës informative të intervistimit të babait të viktimës 15-vjeçare si dhe heqjen e materialit filmik nga kanali zyrtar në Youtube.

Ankesa e paraqitur nga: **Ankues**

Subjekti audioviziv	Programi	Data
Vizion +	Edicion informativ	05.06.2020

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive mbërriti një ankesë lidhur me transmetimin e një kronike televizive në edicionin e lajmeve të televizionit "Vizion +", në të cilën identifikohet babai i një vajze 15-vjeçare, e cila dyshohet të ishte abuzuar dhe dhunuar seksualisht. Ankuesi pretendonte se intervistimi i babait të së miturës, e cila dyshohet të ishte abuzuar dhe dhunuar seksualisht, publikimi i detajeve të tjera të ndjeshme rreth ngjarjes dhe identifikimi i tërthortë i 15-vjeçares, dëmtonin rehabilitimin dhe zhvillimin fizik, mendor e moral të fëmijës.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s, pasi shqyrtoi materialin filmik të kronikës informative, konstatoi shkelje të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive, miratuar me vendimin e AMA-s, nr.228, datë 11.12.2017.

Këshilli i Ankesave çmoi se, intervistimi i babait të së miturës, e cila dyshohet të ishte dhunuar seksualisht, pa marrë masat e duhura teknike, dhe për tepër, duke ekspozuar identitetin e tij dhe, për rrjedhojë, dhe të viktimës, përbente shkelje të rëndë ligjore dhe etike.

Kodi i Transmetimit, në pikën 5.1 ndalon çdo transmetim që mund të çojë në identifikimin e fëmijëve: "OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik". Bazuar në sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive tërhoqi vëmendjen për shkeljen e

Kodit të Transmetimit për median audiovizive dhe kërkoi heqjen e materialit filmik nga kanali zyrtar i televizionit në Youtube.



3

Ankesa të  
rrethuar

Ankesa e paraqitur nga: **A.R**

Subjekti audioviziv

**TV Klan**

Programi

**X Factor Albania**

Data

**14.02.2020**

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Në ankesën, drejtuar Këshillit të Ankesave, A.R pretendonte se gjatë transmetimit të programit "X Factor Albania", një video në të cilën ai ishte protagonist ishte publikuar pa lejen e tij nga ky televizion. Videoja gjithashtu ishte publikuar edhe në kanalin zyrtar të "TV Klan", në "Youtube", në datën 9 Janar 2012.

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Pas shqyrtimit, Këshilli i Ankesave konstatoi se ankesa ishte jashtë afateve ligjore për trajtimin e saj. Pika 2 e nenit 52 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar përcakton se "Ankesa duhet të paraqitet në formë të shkruar në Këshillin e Ankesave brenda 30 ditëve nga data e transmetimit, ose kur në rastin e dy ose më shumë transmetimeve të lidhura me njëra –tjetrën, nga data e transmetimit më të vonë". Në kushtet kur ankesa i referohej një transmetimi të vitit 2012, ajo konsiderohej jashtë afateve të përcaktuara nga ligji.

Nga ana tjetër, publikimi i materialeve të ndryshme në mediat online rezultonte edhe jashtë objektit të punës së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Ligji nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar në nenin 2 përcakton fushën e tij të zbatimit: "Ky ligj zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Ky ligj nuk zbatohet për median e shkruar".



Ankesa e paraqitur nga:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Autoritetit Rrugor

Subjekti audiovizivProgramiData

Anabel Entertainment

Hostel by Anabel 3

13.04.2020

1. Përmbledhje e Ankesës

Autoritetit të Medias Audiovizive i është drejtuar Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Autoritetit Rrugor, e cila ankohej, se episodi i katërt i serialit "Hostel by Anabel 3", shfaqur në kanalin zyrtar të "Anabel Entertainment" në Youtube, në datë 13.04.2020, promovonte sjellje të rrezikshme dhe në kundërshtim me Kodin Rrugor. DPSHTRR pretendonte se promovimi u takonte sjelljeve të papërgjegjshme dhe të qortueshme publikisht, të cilat sanksionohen si shkelje të Kodit Rrugor të Shqipërisë

2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive i trajtoi me vëmendje dhe kujdes materialet përkatëse, bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas nenit 2 të ligjit të sipërcituar (Fusha e zbatimit), ky ligj zbatohet "për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Për sa kohë "Youtube" është një platformë sociale dhe jo një operator i shërbimit mediatik audioviziv, AMA nuk ka tagër ligjor për ta kontrolluar apo monitoruar atë.

Ankesa me  
objekt  
jashtë  
juridiksionit  
të AMA-s

Ankesa e paraqitur nga: **Urdhri i Psikologut**

Subjekti audioviziv

**Portale**

Programi

**Kronika informative**

Data

**26.05.2020**

### 1. Përmbledhje e Ankesës

Autoritetit të Mediave Audiovizive iu drejtua Urdhri i Psikologut, duke sjellë në vëmendje trajtimin në median online të tre ngjarjeve, ku bënte pjesë: "rasti i një të miture 17-vjeçare në Sarandë, e cila akuzote të atin për incest dhe abuzim seksual miqtë e tij", "rasti i një vajze 18-vjeçare nga Korça (për të cilën media kishte paqartësi nëse i kishte mbushur ose jo 18 vjeç), e cila gjithashtu denoncoi të atin se i kishte kërkuar favore seksuale" dhe "rasti i 15-vjeçarit, të dhunuar nga 4 efektivë të policisë, pranë kodrave të Liqenit Artificial, pasi kishte shkelur orarin e karantinës". Sipas ankuesit në kronikat e lajmeve, në emisione dhe portale ishin publikuar duke çuar në identifikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të dhënat personale të të miturve të përfshirë në ngjarje kryesisht me karakter ligjor, "ku informacionet lidhur me identitetin e tyre edhe si dëshmitar/viktimë bëhen publike vetëm me lejen e gjykatës".

### 2. Konkluzioni i Këshillit të Ankesave

Autoriteti i Mediave Audiovizive i trajtoi me vëmendje dhe kujdes materialet përkatëse, bazuar në ligjin nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Sipas nenit 2 të ligjit të sipërcituar (Fusha e zbatimit), ky ligj "zbatohet për transmetimet audiovizive lineare, transmetimet audiovizive jolineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre". Duke qenë se në këtë rast përmbajtja e publikuar në rrjetet sociale nuk rregullohen me këtë ligj, ato nuk janë objekt i punës së AMAs pasi AMA nuk ka tagër ligjor për ta kontrolluar apo monitoruar atë.

Fund

**AUTORITETI I  
MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE**

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II",  
Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë.  
[www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)

këtej, mbështetur në Kodin  
të miratuar nga A  
e Audiovizive i cili përm  
parimet, rregullat, kërkes  
e transmetimeve audioviz  
ën e Shqipërisë, Këshilli i  
n të vëzhgojë me kujdes se  
të mirëpërcaktuara për p  
etimet audiovizive zbatoh  
i Këshillit të Ankesave i  
kohësh ka qenë i mundur  
audioviziv si këshillues i pë  
meve audiovizive, është n  
të cilin raportohen resul  
vara nëpërmjet të cilave dy  
arimet, rregullat, kërkesat